

# **FUNKSIONI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE**

## **Programi 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave**

## Vështrim i përgjithshëm

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për sigurimin e administrimit të çështjeve dhe shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullor, shfrytëzimin e racionalizuar të rezervave pyjore dhe kullor, konservimin dhe zgjerimin e tyre. Bashkia siguron mikëqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore, dhënien e liçencave për prerje pemësh, ripyllëzime, kontrole të dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë.

Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i programit
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	<ul style="list-style-type: none"><li>• Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;</li><li>• Konservim, zgjerim dhe shfrytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;</li><li>• Administrim i fondit pyjor dhe kullor publik;</li><li>• Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh.</li><li>• Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë;</li><li>• Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;</li><li>• Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore;</li><li>• Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes;</li></ul>

Qëllimi i politikës	Objektivat Specifik	Treguesi/Indikatori	Situata 2019	Situata e synuar 2020	Situata e synuar 2021	Situata e synuar 2022	Situata e synuar 2023
Administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	O1: Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullosor brenda territorit administrativ të bashkisë.	Rritja e monitorimit të fondit pyjor kullosor. - Nr. kontrollesh dhe inspektimesh kundrejt Sip. Totale të pyjeve dhe kullotave (inspektime për 100 ha)	3.8	5.7	6.8	7.7	7.7
		Rritja e monitorimit të fondit pyjor dhe kullosor - Numri i punonjësve kundrejt fondit pyjor dhe kullosor (punonjës për 1000 ha pyje dhe kullota)	5.3	5.4	5.4	5.4	5.4
	O2. Hartimi / rishikimi i Planeve të mbareshtimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor.	Rritja e sipërfaqes pyjore që ka plan menaxhimi të fondit pyjor kullosor - Sip pyjore & kullosore me plan menaxhimi / totalit të sipërfaqes pyjore e kullosa. (në %)	23%	40%	60%	80%	100%
		Rritja e sipërfaqes pyjore dhe kullosore e inventarizuar. - Sip. Pyjore & kullosore e inventarizuar, hipotekuar/totalit të sipërfaqes	0%	100%	100%	100%	100%

		pyje kullota. (në %)					
		Zona pyjore ne % ndaj sipërfaqes se zonave urbane Sipërfaqe Pyje/kullota gjithesej 43806 ha / sipërfaqe e zones urbane 3788 ha	11.52%	11.52%	11.52%	11.52%	11.52%
<b>O3.Rehabilitimi dhe pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore/kullosore ,te degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokes nga erozioni ( Projektim/Investim).</b>	1. Permiresimi i fondit pyjor kullosor Permiresimi ne % / vitit paraardhes Investime/ Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit/ sipërfaqes totale të fondit (Lekë për 1 ha pyje dhe kullota)	-	161	103	103	103	
		99	100	94	94	94	



<b>Të dhënat e programit / Vitet</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
Numri i punonjesve në shërbimin e menaxhimit të fondit pyjor dhe kulloror me kohe te plote	14	14	14	14	14
Numri i punonjesve me kontrate	9	10	10	10	10
Totali numri i punonjesve te Programi	23	24	24	24	24
Numri I kontrolleve dhe monitorimeve të fondit pyjor kulloror	168	250	300	336	336
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kulloror në ha	43806	43806	43806	43806	43806
Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit në lekë	13254	20588	16541	16226	16226
Sipërfaqe totale zone urbane (ha)	3787.5	3787.5	3787.5	3787.5	3787.5
Sipërfaqe në ha pyjore me Plan menaxhimi	10154	21330	30500	39500	43806
Sipërfaqe në ha pyjore, kullorore e inventarizuar, /hipotekuar	0	17522	26283	35045	43806
Shpenzime në investime për shërbimin e menaxhimit të fondit (në mijë lekë)	0	7056	1500	1500	1500

Kodi i projektit	Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit	Buxheti 2021 në mijë/lekë	Buxheti 2022 në mijë/lekë	Buxheti 2023 në mijë/lekë
P04260.O1.A1	Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër	9522	9522	9522
P04260.O1.A2	Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore /kullimore/shërbimi pyjor	3519	3519	3519
P04260.O2.A1	Mbledhje e informacionit / përgatitje materialesh për realizimin e rishikimit/hatimit të Planit të	0	0	0
P04260.O2.A2	Përgatitje e materialeve për Realizimin e regjistrimit dhe inventarizimit të Pyjeve dhe kullotave	0	0	0
P04260.O3.A1	Hartim plani i menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Shkodër (Ekonomi Pyjore)	1500	1500	1500
P04260.O3.A2	Shpenzime për përmirësim të Fondit pyjor/kullor	2000	1685	1685

Informacion financiar Programi 4260						
Vitet	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Tavani i përgjithshëm i programit				16,541	16,226	16,226
Shpenzimet bruto	11,342	13,270	30,146	16,541	16,226	16,226
Të ardhurat e programit	6,705	8,852	16,605	12,480	10,952	10,952
Shpenzimet neto	4,637	4,418	13,541	4,061	5,274	5,274
Pagat dhe sigurimet shoqërore				10,917	10,917	10,917
Investimet kapitale				1,500	1,500	1,500

Komente
<b>Programi 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave</b> , ka si burim financimi kryesisht transferten e pakushtezuar sektoriale dhe të ardhurat. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera të bashkisë. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore me rreth 66% për vitin 2021, 67.3% për vitet 2022 dhe 2023. Shpenzimet korente zënë 24.9% për vitin 2021, 23.5% për vitin 2022 dhe 23.5% për

vitin 2023. Shpenzimet kapitale zene 9.1% per vitin 2021, 9.2% per vitin 2022 dhe 9.2% per vitin 2023.

<b>Nr.1</b>	<b>P04260.O1.A1</b> Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër	<b>Funksioni 4</b> : Çeshtje ekonomike <b>N/Funksioni</b> : Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia Lloji programit. 04260 Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b> Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër						
<b>i. Situata</b>						
<p>Administrimi i Pyjeve /Kullotave është një veprimtari e Njësisë së Qeverisjes Vendore – Bashkia Shkodër. Bashkia Shkodër ka krijuar Drejtorinë e Shërbimeve Bujqësore e Pyjore, Sektori i pyjeve i përbërë nga Drejtori, Përgjegjësi i Sektorit, specialiste si edhe 10 teknike të pyjeve me një total prej 14 punonjësish.</p> <p>Struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar ligjit organik, evidenton dhe inspekton fondin pyjor e kulloror nderhyrjet që kryhen në këte fond, zjarret e rënë në pyjet dhe kullotat që administrojnë dhe raportojnë të dhënat statistikore, në përputhje me kriteret e vendosur në përcaktimet e dispozitave ligjore.</p> <p>Shërbimi Pyjor organizohet e vepron sipas parimeve të profesionalizmit, pavarësisë, transparencës, shërbimeve ndaj publikut, përgjegjësisë dhe korrekhtësisë për kryerjen e misionit dhe të detyrave të ngarkuara. Shërbimi Pyjor vepron në pyjet dhe kullotat në pronësi të Bashkisë, në territorin administrativ të saj. Punonjësit e shërbimit pyjor janë me uniformë me shenja dalluese, dokument identifikimi dhe mjete të tjera teknike të nevojshme për kryerjen e detyrës. Caktimi i rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës për punonjësit e shërbimit pyjor publik dhe për inspektorët e policisë pyjore, caktohen me vendim të KM.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të arrihet menaxhim sa më i mirë i fondit pyjor/kulloror në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimit shumë funksional të tyre me ndikim të fuqishëm në rritjen ekonomike të Bashkisë, kryesisht të komunitetit që i përdor ato.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ol style="list-style-type: none"> <li>Administrim i burimeve njerëzore për kryerjen e funksionit.</li> <li>Ndjekje dhe evidentim në vijimësi i ndryshimeve që pësojnë pyjet, kullotat e livadhet, nga demtimet atmosferike, dëmtuesit, sëmundjet, zjarret e faktorë të tjerë, me ndikime në treguesit e ekosistemeve pyjore e kullorore dhe të biodiversitetit, si dhe marrja e masave të nevojshme në zbatim të Ligjit organik.</li> <li>Përditësimi në vijimësi i ndryshimeve që pëson fondin pyjor kulloror, si rezultat i zbatimit të punimeve dhe ndërhyrjeve që kryhen në fondin pyjor e kulloror, si dhe nga shkaqet ose faktorët e ndryshëm.</li> <li>Zbatim i Planit operacional vjetor për aktivitetet vjetore në pyje dhe kullota, bazuar në të dhënat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për vitin referues në planin e mbarështimit.</li> <li>Planifikim i mundësisë vjetore të shfrytëzimit dhe vëllimit të materialit të druve të zjarrit, për nevojat e popullsisë së bashkisë si edhe punimet në fondin pyjor/kulloror.</li> <li>Hartim apo mirëmbajtje e përditësimi i të dhënave pyjore/kullorore.</li> </ol>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>Funksionimi i strukturës së re të krijuar dhe menaxhim i qëndrueshëm i fondit pyjor/kulloror.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti i zonave			Bashkia Shkodër			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2021</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
<b>A.1</b>	<b>Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër</b>					
A.1.1	Paga dhe sigurime shoqërore	9,078	7841	1237		
A.1.2	Shërbim postar	19			19	
A.1.3	Siguracion automjeti	30			30	
A.1.4	Kolaudim automjeti	5			5	
A.1.5	Takse vjetore e automjetit	7			7	
A.1.6	Mirëmbajtje e zakonshme automjeti	210			210	
A.1.7	Shpenzime për pjesë këmbimi goma, bateri	173			173	
	<b>Shuma</b>	<b>9,522</b>	<b>7,841</b>	<b>1,237</b>	<b>444</b>	
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2022</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime

A.1	<b>Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër</b>	9522	7841	1237	444		
	<b>Shuma</b>	<b>9522</b>	<b>7841</b>	<b>1237</b>	<b>444</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operative	Transferim e	Kapitale
A.1	<b>Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër</b>	9522	7841	1237	444		
	<b>Shuma</b>	<b>9522</b>	<b>7841</b>	<b>1237</b>	<b>444</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> janar 2021 – dhjetor 2021 janar 2022 – dhjetor 2022 janar 2023 – dhjetor 2023		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave/Drejtorja e Shërbimeve bujqësore e pyjore. <b>Institucion Likuidues:</b> Drejtorja E Shërbimeve Bujqësore Dhe Pyjore					



Nr.2	<b>P04260.O1.A2.Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore / kullimore/ sherbimi pyjor</b>	<b>Funksioni 4 : Ceshtje ekonomike N/Funksioni : Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia Lloji programit. 04260 Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b> Mbrojtje e sipërfaqeve pyjore/kullimore bazuar në ligjin specifik.						
<b>i. Situata</b>						
<p>1.Mbrojtja dhe Administrimi i Pyjeve /Kullotave eshte veprimtari e Bashkise Shkoder nepermjet Ligjit nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”. Realizimi i sherbimit te Mbrojtjes se Pyjeve / kullotave bazohet ne Ligin nr 57/2020 “ Per pyjet “si edhe ne VKM nr 1080/2010 “Per rregullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve ne pyje dhe kullota, si edhe krijimin e njesive vullnetare te shuarjes se zjarreve”.</p> <p>Rritja natyrore e pyjeve shoqerohet me rritjen dhe zhvillimin e kurores se drureve e cila ne 80-90% te saj eshte e pa krasitur. Kjo shoqerohet me rritjen dhe zhvillimin e shkurreve hijedashese te cilat se bashku me kurorat e pa krasitura krijojne nje shtrese drunore gjysem te njome dhe gjysem te thate e cila perben rrezik potencial per djegien nga zjarret e mundshme. Djegiet asnjehere nuk kane ardhur si zjarre te rastesishme por kane qene zjarrrvenie te qellimshme. Nisur edhe nga ndryshimet klimatike te cilat jane shoqeruar me rritje te temperaturave, por edhe me thatesire, mbrojtja e sipërfaqes pyjore/kullimore eshte nje domosdoshmeri.</p> <p>Referuar Vendimit te mesiperme te Keshillit te Ministrave ku shprehimisht jane te paraqitura detyrat: “Organizojnë sistemin e vrojtimit – sinjalizimit, i cili funksionon gjatë gjithë vitit në shkallë të ndryshme gatishmërie, në varësi të sezonit të zjarreve. Organizojnë, për shuarjen e zjarreve dhe eliminimin e pasojave të tyre, njësitë vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHZ), me 5-15 vullnetarë, të cilët veprojnë gjatë periudhës 1 maj – 15 tetor, për pyjet në pronësi të qeverisjes qendrore. Bashkia do te caktojë 10 punonjës/vrojtues me kontrate te perkohshme per nje periudhe 5 mujore ne zonat pyjore NjA Postribe, NjA Guri i Zi, NjA Pult, NjA Shale etj. Pikerisht, keto jane zonat, te cilat kane mundesine me te madhe te rrezikshmerise nga zjarret.</p> <p>2.Gjithashtu ne zbatim te dispozitave te mesiperme per rastet e shuarjes se zjarreve masive, nevojiten punonjes te perkohshem, propozohet te jete ne dispozicion nje fond per sherbimin e perkohshem, per shuarje zjarri i cili planifikohet si honorar lek/ore te sherbimit te kryer. Llogaritet qe honorari te jete 1835 lek/ore sherbimi te kryer per person.</p> <p>3.Ne kuader te mbrojtjes se pyjeve/kullotave dhe sherbimit ndaj tyre Bashkia Shkoder planifikon te kryeje sherbimin per “ Nderhyrje sanitare ne pyllin e geshtenjes” . Aktualisht ne territorin e bashkise Shkoder ka rreth 3500 ha me geshtenje. Per vete rendesine qe ka ky frut pyjor parashikohet qe te nderhyet me nje fond per pastrimin dhe prerjet sanitare ne menyre qe te mbrohet nga ndjegjet dhe te shendoshet pylli i geshtebjes. Si rezultat do te keni nje rritje te prodhimit te geshtenjes per rrjedhoje edhe rritje te te ardhurave per banoret e zones.</p> <p>4.Si sherbim i ri i transferuar ne baze te ligjit nr 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 57/2020 “Per Pyjet “ edhe akteve nenligjore ne zbatim te ligjit, ky sherbim i kaluar prane Bashkise ka nevojte per tu kompletuar me mjete per te realizuar nje sherbim sa me cilesor. Aktualisht nga transferimi i aseteve nga ish DSHP /MM, Bashkia Shkoder nuk iu transferua asnje aset per kete sherbim. Per kete arsye planifikojme te realizojme blerjen e nje automjeti tip kamion te pershtatshem per sipërfaqet pyjore . Ky automjet do i sherbeje specialisteve dhe teknikeve te sektorit te pyjeve dhe kullotave per nje kontroll sa me te mire te territorit dhe realizimin e detytrave te percaktuara.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nepermjet ketij aktiviteti do te arrihet te mbrohet sipërfaqja pyjore/kullimore nga zjarret te cilat ne te shumten e rasteve jane zjarrrvenie te qellimshme.</li> <li>• Nepermjet vrojtuesve arrihet te njoftohet ne kohe per rastet e zjarreve dhe parandalohen keto zjarrrvenie.</li> <li>• Njekohesisht planifikimi i punonjesve te perkohshem eshte i nevojshem qe ne raste te zjarreve masive te jete mundesia qe te merren punonjes shtese per shuarjen e ketyre zjarreve dhe shpëtimin e pyjeve/kullotave nga djegiet.</li> <li>• Nje aspekt tjetër i mbrojtjes se pyjeve eshte edhe investimi per blerjen e nje automjeti ne funksion te ketij sherbimi..</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ol style="list-style-type: none"> <li>1.Sherbimi i mbrojtjes se pyjeve/kullotave nga zjarri.</li> <li>2.Sherbimi i pastrimit te pyjeve te geshtenjes ne NjA Pult, Shale dhe Shosh nepermjet heqjes se materialeve drusore te formuara ne menyre natyrore.</li> <li>3.Blerje automjet kamion per sherbimin pyjor.</li> <li>4.Ruajtja e fondit pyjor nga keqberesit dhe pajisja e specialisteve me arme.</li> </ol>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve/ kullotave nga djegia. Zjarret jane nje nga demtuesit kryesore te pyjeve/kullotave. Nepermjet ketij sherbimi do te arrijme qe te mbrojme pyjet nga demtimi duke i konsideruar keto pyjet/kullotat si nje pasuri e rendesishme ne sherbim te komunitetit te Shkodres dhe me gjere.</li> <li>• Administrim me i mire dhe evidentim ne kohe i problematikave ne zone.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
				Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2021</b>		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	<b>Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore / kullimore/ sherbimi pyjor</b>					
A.1.1	Vrojtues per 5 muaj/ Paga dhe sigurime shoqerore	1,839	1,588	251		

A.1.2	Honorar per sherbim shuarje zjarri 1835 lek/ore pune per punetor	413			413		
A.1.3	Blerje kamion per sherbimin pyjor	1167			1167		0
A.1.4	Blerje material per sherbimin pyjor	100			100		
A.1.5	Pajisje e specialisteve pyjore me arme						
	<b>Shuma</b>	<b>3,519</b>	<b>1,588</b>	<b>251</b>	<b>1680</b>		<b>0</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2022</b>		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	<b>Mbrojtja e siperfaqeve pyjore / kullosore/ sherbimi pyjor</b>						
A.1.1	Vrojtues per 5 muaj/ Paga dhe sigurime shoqerore	1,839	1,588	251			
A.1.2	Honorar per sherbim shuarje zjarri 1835 lek/ore pune per punetor	413			413		
A.1.3	Nderhyrje sanitare ne pyllin e geshtenjes	760			760		
A.1.4	Blerje material per sherbimin pyjor	507			507		
	<b>Shuma</b>	<b>3,519</b>	<b>1,588</b>	<b>251</b>	<b>1,680</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	<b>Mbrojtja e siperfaqeve pyjore / kullosore/ sherbimi pyjor</b>						
A.1.1	Vrojtues per 5 muaj/paga sigurime shoqerore	1,839	1,588	251			
A.1.2	Honorar per sherbim shuarje zjarri 1835 lek/ore pune per punetor	413			413		
A.1.3	Nderhyrje sanitare ne pyllin e geshtenjes	760			760		
A.1.4	Blerje material per sherbimin pyjor	507			507		
	<b>Shuma</b>	<b>3,519</b>	<b>1,588</b>	<b>251</b>	<b>1,680</b>		
f) Periudha e zbatimit janar 2021 – dhjetor 2021 janar 2022 – dhjetor 2022 janar 2023 – dhjetor 2023		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. <b>Institucion Likuidues:</b> Drejtoria E Sherbimeve Bujqesore Dhe Pyjore					

<b>Nr.3</b>	<b>P04260.O2.A1</b> Mbledhje e informacionit, pergatitje materialesh per realizimin e rishikimit/hartimit te Planit te menaxhimit	<b>Funksioni 4</b> : Ceshtje ekonomike N/Funksioni : Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia Lloji programit. 04260 Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave				
<b>a)Përshkrimi i shkurtër i projektit</b> Rishikimi/hartimi i planit te Menaxhimit te Pyjeve e Kullotave per Ekonomite pyjore/kullosore te NJA. Hartimi i Planeve te menaxhimit eshte nje domosdoshmeri ne mire funksionimin dhe administrimin e fondit pyjor kullosor.						
<b>i. Situata</b> Pergatitja e planeve të menaxhimit apo rishikimi i tyre , nëpërmjet studimit dhe analizave të të gjithë elementeve , treguesve sasiorë dhe cilësorë përcaktimi i prioriteteve per nderhyrje ne zonat pyjore/kullosore do te beje qe te kemi nje zhvillimit të qëndrueshëm ,në funksion të rritjes së kapaciteteve prodhuese e të përmirsimit të funksioneve të tjera që këto pyje e kullota afrojnë. Percaktimi i zones se nderhyrjes per realizimin e Planit do te behet menjehere sapoo te jete realizuar edhe regjistrimi i pronave pyje/kullota prane ZVRPP. Percaktimi do te behet ne bashkepunim me Administratoret e NJA te zonave pyjore si edhe komunitetit te zones.						
<b>ii. Synimi i projektit</b> Të përmirësohet kontrolli mbi territorin për një planifikim më të mirë të përdorimit të resursëve natyrore dhe mbrojtjes së tyre. Përputhja e projektit me Qëllimet dhe Objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të realizohen si Hartimin e politikave per menaxhimin e qendrueshem te pyjeve dhe kullotave, zhvillimin e nje ekonomie te gjelber, koordinimin ne nivel rajonal dhe lokal te praktikave me te mira ne fondin pyjor dhe kullosor, efçence nga pikpamja ekonomike, miqësore me mjedisin dhe të pranuar nga shoqëria.						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b> Referuar edhe projektit te regjistrimit dhe inventarizimit te pronave te realizohen hap mbas hapi rishikimet e planeve apo edhe hartimet e tyre per zonat sipas parashikimeve. Mbledhja e informacionit të nevojshem dhe përdorimi i tij në funksion të orientimit të ndërhyrjeve. Koordinimi i informacionit të mbledhur me drejtoritë e linjës në Bashkinë Shkodër dhe institucionet e tjera që kanë të bëjnë me administrimin e pyjeve dhe kullotave.						
<b>b) Rezultatet që prisni</b> Hartimi i planeve te menaxhimit eshte dokumenti strategjik me i rendesishem ne fushen e menaxhimit dhe kontrollit ne pyje dhe kullota. Hartimi i tyre <ul style="list-style-type: none"> <li>• planifikimin dhe orjenton investimet ne kete fushë.</li> <li>• parandalimin e situatave te pakendeshme që krijohen në raste të veçanta.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Bashkia Shkodër Ministria e Mjedisit NJA, komuniteti i zones CNVP, Shoqata e përdorimit të pyjeve Organizata të cilat mbështesin aktivitetin e pyje/kullotave. Subjekte private te interesuar.				Bashkia Shkoder		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura per cdo aktivitet të mësiperm (pika iii)</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2020</b>		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime
A.1	Mbledhje e informacionit / pergatitje materialesh per realizimin e rishikimit / hatimit te planit te menaxhimit per Ekonomite Pyjore/kullosore ne NJA.	0				0
<b>Shuma</b>		<b>0</b>				<b>0</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2021</b>		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime
A.1	Mbledhje e informacionit / pergatitje materialesh per realizimin e rishikimit / hatimit te planit te menaxhimit per Ekonomite Pyjore/kullosore ne NJA.	0				0
<b>Shuma</b>		<b>0</b>				<b>0</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2022</b>		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime
A.1	.Mbledhje e informacionit / pergatitje materialesh per realizimin e hartimit te Planit te menaxhimit per Ekonomite Pyjore/kullosore ne NJA.	0				0
<b>Shuma</b>		<b>0</b>				<b>0</b>

**f) Periudha e zbatimit**

janar 2021 – dhjetor 2021  
janar 2022 – dhjetor 2022  
janar 2023 – dhjetor 2023

**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**

Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave/Drejtoria e Shërbimeve bujqësore e pyjore.  
**Institucion Likuidues:** Bashkia Shkoder

Nr 4	<b>P04260.O2.A2: Përgatitje e materialeve per Realizimin e regjistrimit dhe inventarizimit te Pyjeve dhe kullotave bashkiake.</b>	<b>Funkzioni 4 : Ceshtje ekonomike</b> <b>N/Funksioni : Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia</b> <b>Lloji programit. 04260 Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave</b>				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
<b>i.Situata.</b>						
<p>Gjendja e kadastres se pyjeve dhe kullotave ne vendin tone i referohet viteve 1985-1990. Aktualisht nuk ka nje kadaster te azhornuar te pyjeve e kullotave si edhe invenatrizim te fondit pyjor. Si e tille Ministria e Mjedisit dhe Turizmit ka marre iniciativen qe ne kuader te "Projektit te Sherbimeve Mjedisore" ne bashkepunim edhe me pushtetet vendore te mund te realizohet ky proces. Pjese e ketij procesi shume te rendesishem do te jete edhe bashkia Shkoder/Drejtoria e mjedisit pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.</p> <p>Në kuadër të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative – territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia Shkodër përbëhet nga 11 njësi administrative, të cilat janë: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë. Pjesë e pronave të Bashkisë aktuale jane edhe pyjet/kullotat. Me VKM nr. 433/2016 eshte bere transferimi ne pronesi te Bashkise Shkoder i pyjeve dhe kullotave publike te cilat kane qene nen administrim te MM dhe ish komunave. Pika 48 e ketij vendimi ngarkonte Njesite e Qeverisjes Vendore per regjistrimin prane ZVRPP te ketyre pronave.</p> <p>Regjistrimi i të gjithë pyjeve/kullotave përveçse një sfidë, është edhe detyrim ligjor. Kjo kërkon hartimin/përgatitjen e dokumentacionit për rievimet topografike për të realizuar regjistrimin e ketyre pronave.</p> <p>Me Vendim te Keshillit të Bashkisë Shkodër nr 6 datë 22.01.2020 eshte bere saktësimi i sipërfaqeve të të gjitha parcelave të Ekonomive Pyjore/Kullosore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Shkodër. Ndërkohë në vijimësi të kësaj pune po vazhdohet më azhornimin e të dhënave për seicilën parcelë pyjore duke shtuar llojin e përdorimit të tokës, moshën , prodhimtarinë etj. Jemi në koordinim me MTM si edhe me Projektin e BB po ndihmojmë për përgatitjen e materialeve për regjistrim pranë ASHK , ndërkohë që inventarizimi ka përfunduar.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit:</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Databaze e sakte e siperfaqeve te pyjeve dhe kullotave bashkiake/regjistrim ne ZVRPP si dhe orjentim i drejte i financimeve ne fushen e sherbimeve mjedisore/pyje.</li> <li>• Të arrihet menaxhim sa më i mire i pyjeve sipas udhëzimeve të përcaktuara dhe në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimit shumëfunksional të tyre me ndikim të fuqishëm në rritjen ekonomike të Bashkisë, kryesisht të komunitetit që i përdor ato.</li> <li>• Të përmirësohet qeverisja vendore dhe ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve.</li> <li>• Qëllimi themelor i këtij projekti është regjistrimi pranë ZVRPP Shkodër i të gjitha pyjeve/kullotave të cilat janë pronë e bashkisë Shkodër sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për inventarin e pyjeve/kullotave që kalojnë në pronësi të bashkise.</li> <li>• Ky eshte nje projekt qe ka nje kohezgjatje te pakten 3 vjecare.</li> </ul>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit .</b>						
1. Bashkepunimi me Ministrine e Mjedisit / Organizatat e tjera si CNVP , Shoqatat e Pyjeve etj.						
1. Përgatitja e materialeve hartat, relacione, dokumentacion për të regjistruar pranë ZVRPP Shkodër.						
<b>b) Rezultatet qe prisni</b>						
• Regjistrimi i pronave pyje/kullota dhe marrja e certifikatës/vertetimit Hipotekor për pasuritë e rregjistruara.						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Bashkia Shkodër Ministria e Mjedisit Shoqata e përdorimit të pyjeve Organizata të cilat mbështesin aktivitetin e pyje/kullota.			Bashkia Shkoder			
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2020</b>		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Përgatitje e materialeve për regjistrimin dhe inventarizimi i pyjeve dhe kullotave					
<b>Shuma</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2021</b>		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Perditesim dhe azhornim e materialeve te regjistruara prane ZVRPP .					
<b>Shuma</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2022</b>		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me

A.1	Perditesim dhe azhornim e materialeve te regjistruara prane ZVRPP .						
	<b>Shuma</b>						
	<b>f) Periudha e zbatimit</b> janar 2020 – dhjetor 2020 janar 2021 – dhjetor 2021 janar 2022 – dhjetor 2022	<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtorja e Sherbimeve bujqesore e pyjore. <b>Institucion Likuidues:</b> Bashkia Shkoder					

<b>Nr 5</b>	<b>P04260.O3.A1. Hartim plani i menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave te Bashkise Shkoder (Ekonomi Pyjore)</b>	<b>Funksioni 4 : Ceshtje ekonomike</b> <b>N/Funksioni : Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia</b> <b>Lloji programit. 04260 Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave</b>					
<b>Pershkrimi i shkurtër i projektit:</b> Projektimi dhe investimi i nderhyrjeve ne fondin pyjor kulloros me qellim zhvillimin e qendrueshem te fondit pyjor kulloros , kjo arrihet vetem duke arritur te realizohen punime konkrete bazuar ne Plane Menaxhimi te cilat parashikojne punime afatgjata.							
